



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIĆ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRQJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlasna

Nr. 1-77

Data 03.05.2018

Br.

Datum

OBILIQ-OBILIĆ



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenit 61 të Statutit të Komunës së Obiliqit, caktoj:

Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa me dt. 10.05.2018, (e enjete) në ora 10:00 në sallën e Kuvendit komunal me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Draft Rregullores për përdorimin e automjeteve zyrtare në Komunën e Obiliqit
4. Shqyrtimi i Draft Rregullores së punës së Kuvendit komunal
5. Të ndryshme

Kryesuesi i Komitetit

Burim Gërguri



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.26.04.2018, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm janë këta anëtarë: Burim Gërguri, Florije Jashari, Qëndresa Dubova, Linda Sadiku, Hysni Mjeku, Armend Rushiti dhe Slavisa Spasic

Të pranishmit tjerë: Ajet Berisha, Nënkyetar i Komunës, Përparim Klinaku, drejtor i Drejtorisë së admnistratës së përgjithshme, Agim Spahiu, drejtor i DKA-së, Enver Graiqevci, drejtor i Drejtorisë për infrastrukturë lokale, Zarife Behluli, drejtoreshë e DFEZH, përf.e KFOR-it, përf.e OSBE-së

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Draft Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha komunale
4. Shqyrtimi i Planit të Punës së Kuvendit komunal për vitin 2018
5. Raporti financiar 3 mujor i DFEZH
6. Të ndryshme

Burim Gërguri – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës.

Aprovohet njëzërit rendi i ditës, i cekur më lartë.

I.Pika e parë e rendit të ditës –

Prezentë janë të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa.

II.Pika e dytë e rendit të ditës –

Aprovohet njëzërit ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

III.Pika e tretë e rendit të ditës –

Hysni Mjeku – Unë nuk e di kjo Rregullore është ndarë në 2 pjesë, pjesa për tarifa dhe gjoha dhe kjo sikur po përsëritet për çdo vit. Mendoj se kjo nuk duhet të jetë kështu, por për tarifa dhe gjoha është dashur të jetë në pjesën përfundimtare të Rregullores sepse këshut siç është po del se kryesuesi i nënshkruan 2, edhe Rregulloren këndeje por njëkohësisht edhe për tarifa. Këtu, po del sikur kemi të bëjmë me 2 Rregullore, por në fakt e kemi vetëm një Rregullore për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale. Poashtu, në këtë Rregullore nuk figuron tarifa për gurëgdhendës.

Burim Gërguri – Kjo është një Rregullore unike për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale dhe sipas Udhëzimit të fundit nga MAPL-ja, që ka ardhë Rregulloret dhe vendimet duhet të jenë unike në nivel të vendit. Ne do të bisedojmë me zyrtarin kompetent lidhur me tarifën për gurëgdhendës, që nuk është përfshirë në këtë Rregullore dhe do ta rregullojmë këtë çështje.

Hysni Mjeku – Edhe mullinjët me ujë fare nuk janë cekë në Rregullore.

Burim Gërguri – Sqaron se mullinjët me ujë janë pa pagesë dhe kjo është stimulim për ata që dëshirojnë të aktivizojnë mullinjët me ujë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë :


REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim Draft Rregullorja për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale.

IV.Pika e katërt e rendit të ditës –

Burim Gërguri – Lexon Planin e punës të Kuvendit komunal, për mbledhjet që janë paraparë të mbahen dhe aktet normative, që duhet të aprovohen gjatë vitit 2018.

Armend Rushiti – Me datën 9 maj është ditë feste, “Dita e Evropës” dhe mbajtja e mbledhjes duhet të jetë



Dalës-izlaza

Nr. -1-67

Br.

DËLLIĆ-DËLLIĆ

Data

Datum

26.04.2018

një ditë më heret ose një ditë më vonë, e jo me 9 maj siç figuron në Plan të punës të Kuvendit komunal.

Burim Gërguri – Atëherë, e korrigjojmë dhe mbledhjen e mbajmë me datën 10 maj. Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit komunal shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës së Kuvendit komunal.

V.Pika e pestë e rendit të ditës –

Burim Gërguri – Tash e tutje raporti financiar do të jetë në 4 perioda dmth çdo 3 muaj, dhe raporti i Kryetarit ndoshta do të jetë në 2 perioda.

Hysni Mjeku – Fillimisht është mirë që drejtoresha të japë një ekspozë, pastaj ne debatojmë dhe duhet të kyqen në debat edhe anëtarët tjerë të Komitetit.

Zarife Behluli – Te Drejtoria e administratës të hyra janë 3,789 €, te tatimi në pronë janë 231,361.09 €, ekonomia 84,168.88 €, te Kadastrri janë 15,780 €, te Urbanizmi janë 100.00 €, te Planifikimi mjedisor janë 170.00 €, te Shëndetësia, participimet në shëndetësi janë 4,630.30 €, te DKRS janë 720 €, te çerdhja 5034 €, te Shkollat e Mesme 18,278.00 €, te denimet në trafik janë 6,710.00 €. Në total grumbullimi i të hyrave vetanake janë 371,011.27 €. Totali i buxhetit të aprovuar për vitin 2018 është 6,851,926.00 €. Në total shpenzime për 3 mujorin e parë janë 1,078,129.74 €, duke i përfshirë 5 kategoritë ekonomike paga dhe medijtje, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere dhe projektet kapitale.

Burim Gërguri – Dua të bëjë një koment se Instituti GAP, dje e kishte nxjerrë një raport financiar për Komunitat lidhur me obligimet që i kanë pasë nga vitet paraprake dhe jashtëzakonisht mirë qëndron Komuna e Obiliqit, në krahasim me miliona që ishin në Komunitat tjera si Prishtina, Ferizaj dhe Prizreni. Komuna jonë ishte në ato 5 Komunitat, që kishin vetëm obligime kontigjente që kanë kaluar, e jo obligime financiare.

Hysni Mjeku - Këtu figuron se vetëm për sindikatën janë ndarë 3,900 €, por nuk dihet se për cilën sindikatë është fjala, e administratës apo e shëndetësisë. Unë kam informacione se sindikata e administratës nuk i ka marrë 1,500 €, sepse ne nuk kemi kurrfarë vendimi dhe pyes se me çfarë vendimi janë ndarë këto mjete. Unë nuk di që ka vendim të Kuvendit komunal për ndarjen e këtyre mjeteve për sindikatën, apo që kemi pasë ndonjë kërkesë. Pastaj, shërbime kontraktuese tjera janë 15,900 €, që unë nuk e di se për çfarë kontraktimi bëhet fjalë dhe kjo është një shumë marramendëse për Komunën tonë. Te shpenzimi për anëtarësim figurojnë 5,000 €, dhe pyes se për çfarë anëtarësimi bëhet fjalë. Te furnizimi me ushqime dhe dreka zyrtare figurojnë 4,451 € për 3 muajt e fundit. Kujtoj se këto janë shpenzime marramendëse për Komunën tonë aq të vogël me këto shpenzime aq të mëdha. Unë sa e vërejtja Drejtoria e inspeksionit ka denime vetëm në trafik, ndërsa për inspeksionin sanitar dhe tjerat fare nuk kemi të dhëna.

Zarife Behluli – Përgjegjet se ne nuk kemi bërë pagesë për sindikatë, por tatimi në pagë, trusti pensional, pagesa për sindikatë dhe çdo pagesë tjetër që ekziston shkon përmes listës së pagave. Pra, pagesa e sindikatës, bëhet për ata punëtorë që janë të anëtarësuar në sindikatë dhe këtu hyn Arsimi, Shëndetësia, administrata komunale, që është në total shpenzimi i pagave për Komunën e Obiliqit 627 zyrtarë, staf i punësuar. Ishte vërejtja ushqim, pije dhe dreka jozyrtare, kjo është pagesa për ushqimin e fëmijëve të institucionit parashkollor në shumën prej 4,451.08 €.

Burim Gërguri - Shumë mirë po shkruan kodi 13,620, furnimzim me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare).

Zarife Behluli – Edhe një vërejtje ishte te shpenzimet për anëtarësim, por janë marrëveshjet e nënshkuara me Agjencionin zhvillimor rajonal dhe me Asociacionin e Komunave, që ne jemi të obliguar ti bëjmë pagesat në bazë të marrëveshjeve të lidhura. Shërbimet kontraktuese e tjera, është pjesë e grumbulluar me secilën Drejtori sepse në vitin 2017 na i kanë bërë 5 nënkode, për secilin shpenzim dhe tash ne për me mund me i shfrytëzue mjetet, i kemi shërbimet tjera kontraktuese dhe kjo është në kategorinë mallra dhe shërbime. Pastaj, DSHPE dhe Drejtoria e administratës për material zyrtar që ju nevojiten ne i kryejmë te shërbimet tjera kontraktuese, në bazë të kontratave të lidhura.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit komunal shqyrtimi i Raportit financiar 3 mujor i DFEZH.

VI.Pika e gjashtë e rendit të ditës

Burim Gërguri – lexon kërkesën nga Drejtoria e Arsimit për ç'fuqizim të vendimit nr.I-103, të dt.23.11.2017, të marrë në Kuvendin komunal për lokacionin e paraparë për ndërtimin e Kopshtit për fëmijë, të financuar sipas programit IPA, 2.

Ajet Berisha – kjo mundësi nga IPA, ka qenë në vitin 2016 dhe është nxjerrë një vendim për ndërtimin e çerdhes në Milloshevë, dhe nuk di për çfarë arsye ata nuk kanë pranue, por arsyetimi i tyre bazë ka qenë se afër magjistrales nuk mund të lejohet dhe është ndryshue lokacioni. Në lokacionin e ndryshuar Kuvendi prapë ka nxjerrë vendim dhe përballë Katanës është një hapësirë komunale aty, për ndërtim të çerdhes dhe shkollës. Më vonë ka dalë që këto 2 parcela, të ndara nga Kuvendi komunal janë të kontestuara gjygjësisht. Nga të gjitha analizat që i kemi bërë ka dalë se këto parcela të propozuara janë në pozicionin më të mirë që s'kanë probleme ligjore dhe unë ju lus që ta rekomandoni për Kuvend.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit komunal kërkesa nga Drejtoria e Arsimit për shqyrtim të vendimit nr.-I-103, të dt.23.11.2017, dhe vendimit nr.-I-36, të dt.29.03.2017.

Burim Gërguri – lexon kërkesën nga Alban Përvetica, nga Millosheva për emërtim të rr."Përvetica" sepse në hyrje të rrugës është tabela me emrin "Përvetica" por në listën e emërimeve nuk është e regjistruar.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet DPUKP-së për shqyrtim kërkesa nga Alban Përvetica, nga Millosheva për emërtim të rr. "Përvetica".

Përparim Klinaku – e kemi një kërkesë për formimin e Komitetit të auditimit, pasi që kemi vërejtje çdo vit nga auditori i jashtëm.

Pas propozimit të drejtorit të administratës së përgjithshme, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit komunal kërkesa për formimin e Komitetit të auditimit.

Hysni Mjeku – dje është intervenuar te banorët e fshatit Hade dhe kam shpresue se kësaj radhe drejtori i inspeksionit do të na informoj rreth ngjarjes së djeshme se çka ka ndodhë. Unë propozoj që në seancën e Kuvendit Drejtoria e inspeksionit të na jepë informacione detale se çfarë intervenimi është bërë dhe në çfarë kushtesh. Unë e di se në faqen zyrtare të Komunës po dalin disa informacione, të donacioneve dhe të ndarja e projekteve, kërkoj që ta kemi një regjistër dhe ta dijmë se kush janë përfituesit e këtyre donacioneve dhe në bazë të cilave kritere janë ndarë. Ne kemi informacione jashtëzakonisht të bollshme se anëtarët e subjekteve politike janë të favorizuar në këtë drejtim dhe nëse kjo vazhdon kështu ne do të gjejmë metoda dhe forma të ndryshme për të protestuar dhe kundërshtuar. Unë konsideroj se ky Kuvend nuk guxon të anashkaloj asnjë qytetar në këto drejtime. Nëse, jam i gabuar kërkoj falje, por mbi të gjitha dua të kemi një informacion më detal në mbledhjen ardhshme të Kuvendit.

Burim Gërguri – Të gjitha subvencionet që janë për kulturë, për bujqësi bëhet thirrja për aplikim, janë Komisionet dhe ndahen në bazë të Rregullores së aprovuar.

Ajet Berisha – Tash, a kanë marrë anëtarët e subjekteve politike me thirrë Komisionin në përgjegjësi sigurisht ka me thënë se ka vendosë në bazë të kritereve sepse shpallja ka qenë publike dhe njerëzit mund të konkurojnë. Psh për një serë kanë konkurue 3 vetë dhe të tre i kanë plotësue kriteret, vendosë Komisioni se cili prej tyre do të jetë fitues.

Hysni Mjeku - Nëse, janë ndarë në bazë të kritereve, atëherë është në rregullë.

Mbledhja përfundoi në ora 11:00

Bashk. prof. për punë të KK-së


Azize Zeneli

Kruesuesi i KPF-së


Burim Gërguri

